



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 131, Datë 10.08.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES SË
FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, VKM Nr. 449, datë 15.6.2016 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/5 Prot, datë 05.08.2020, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit, në Sektorin e Energjisë Elektrike,

Konstatohet se:

- Në nenin 87, pika 2, të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se : *ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton furnizuesin e mundësisë së fundit.*
- Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 449, datë 15.6.2016 ka vendosur “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike. Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar "Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike ku parashikohet se deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.
- Me vendimin e bordit të ERE Nr. 115, datë 08.07.2016, mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike, bordi i ERE ka vendosur që: Të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në 31.12.2016. 2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit sipas parashikimeve të Vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 449, datë 15.06.2016.

- Në vijim për këtë vendimarrje, bordi i ERE është shprehur me vendimin Nr. 96, datë 4.7.2017, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s Nr. 115, datë 7.8.2016, "mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike", duke vedosur: 1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të vendimit të ERE-s Nr. 115, datë 7.8.2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.
- Për qëllime të përmbushjes së detyrimeve sa më sipër, është draftuar Rregullorja e cila ka për objekt të saj, të caktojë procesin e përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit që i kërkohet të kryejë shërbimin e furnizimit në përputhje me nenin 87 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe VKM Nr. 449, datë 15.6.2016, "Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike".
- Elementet që mbahen në konsideratë në hartimin e kësaj rregulloreje, janë parashikimet e nenit 87 të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë elektrike" si dhe VKM nr. 449, datë 15.06.2016.
- Sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të të licencuarit të përzgjedhur si Furnizues i mundësisë së Fundit dhe klientëve që përfitojnë këtë shërbim janë ato që parashikohen në Rregullat për kushtet e shërbimit të furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike të miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e rregullore për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në Sektorin e Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI